



### KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot më datën 05.05.2000 (dymije), në zyrën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Myrvete PËRMETI, ndërmjet:

- a) **Perikli KARAVELLA**, lindur në Kavaje më 26.12.1956, banues në Rr. "Xhorxh Bajron", Nr.54/4 Laprake Tirane, mbajtës i pasaportes Nr. 0263078, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, (në vazhdim i quajtur "Shitësi").
- b) **Dritan Hoxha**, i biri i Fiqiriut, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Nr. 0161795, (në vazhdim e quajtur "Blerësi").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. Shitësi ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të 400 (katerqind) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili. Këto aksione përfaqësojnë 20% të kapitalit aksioner të shoqërisë anonime pa oferte publike "TELEVIZIONI ARBERIA" sh.a, me emër të shkurtuar TV.A., shoqëri që është themeluar dhe që vepron sipas legjislacionit shqiptar, rregjistruar si person juridik në Gjykatën e rrethit Tirane Nr.22058 date 04.10.1999.
2. Shitësi i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të aksioneve të sipërpërmendura, pra të 400 (katerqind) aksioneve të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili, që përfaqësojnë 20% të kapitalit aksioner të shoqërisë "TELEVIZIONI ARBERIA" sh.a, me emër të shkurtuar TV.A., me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre Blerësit. Pagesa e vlerës së aksioneve të mësipërme është shlyer nga ana e Blerësit. Palët kontraktuese do të procedojnë njëkohësisht në rregjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të Shoqërisë "TELEVIZIONI ARBERIA" sh.a, me emër të shkurtuar TV.A.,
3. Shitësi deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë defekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
4. Palët bien dakort që Shitësi nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj Blerësit në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.
5. Pas transferimit të aksioneve, Shitësi nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe Blerësi të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë të zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. Blerësi ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

6. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë hartohet në kater (4) origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, një kopje mbahet nga Noteri Publik dhe një kopje depozitohet në Gjykatë, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

### PALËT KONTRAKTUESE


#### SHITËSI

1- PERIKLI KARAVECCA




#### BLERËSI

2 Jutana Hoxha



#### NOTERI





### KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot më datën 05.2000 (dymije), në zyrën e Noterisë Tiranë para meje Noteres Publike Myrvete PËRMETI, ndërmjet:

- a) **Roke KORO**, lindur me 13.12.1961 ne Tirane dhe banues ne Yzberisht Tirane, me pasaporte Nr.0547933, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, (në vazhdim i quajtur "Shitësi").
- b) **Dritan Hoxha**, i biri i Fiqiriut, lindur më 1968, banues në Tiranë, me adresë Rruga "Pandi Dardha", Pall.60, Ap.28, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pasaportën Nr. 0161795, (në vazhdim e quajtur "Blerësi").

Është rënë dakort sa më poshtë vijon:

1. Shitësi ka të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë e posedimit të **800 (teteqind) aksioneve** të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili. Këto aksione përfaqësojnë **40% të kapitalit aksioner** të shoqërisë anonime pa oferte publike "TELEVIZIONI ARBERIA"sh.a., me emer te shkurtuar **TV.A.**, që vepron sipas legjislacionit shqiptar, në bazë të rregjistrimit si person juridik ne Gjykatën e Rrethit Tirane Nr.22058 date 04.10.1999.
2. Shitësi i shet, transferon e dorëzon pronësinë dhe posedimin e plotë të një pjese të aksioneve të sipërpërmendura, dhe më saktë të **260 (dyqind e gjashtëdhjetë) aksioneve** të rregjistruara me një vlerë nominale prej një mijë (1,000) Lek secili, që përfaqësojnë **13% të kapitalit aksioner** të shoqërisë anonime "TELEVIZIONI ARBERIA"sh.a., me emer te shkurtuar **TV.A.**, me të gjitha të drejtat që rrjedhin prej tyre **Blerësit**. Pagesa e vlerës së aksioneve të mësipërme është shlyer nga ana e **Blerësit**. Palët kontraktuese do të proçedojnë njëkohësisht në rregjistrimin e duhur të këtij transaksioni si në Librin e Aksioneve, ashtu dhe në Librin e Aksionerëve të Shoqërisë "TELEVIZIONI ARBERIA"sh.a., me emer te shkurtuar **TV.A.**
3. Shitësi deklaron se aksionet transferohen të lira dhe të pastra nga çdo peng, barrë ose detyrim tjetër ligjor, ose ndonjë difekt aktual ose ligjor në përgjithësi.
4. Palët bien dakort që **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë tjetër ndaj **Blerësit** në lidhje me blerjen e këtyre aksioneve.
5. Pas transferimit të aksioneve, **Shitësi** nuk ka asnjë të drejtë ose titull mbi këto aksione dhe **Blerësi** të cilit i janë transferuar dhe dorëzuar aksionet në kushtet e pronësisë dhe posedimit të plotë, ka të drejtë ti zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe

rregullojë ato sipas vullnetit të tij të lirë si pronar dhe posedues i tyre. **Blerësi** ka të drejtë të ushtrojë të tëra të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

6. Palët kontraktuese deklarojnë se heqin dorë nga e drejta për ta apeluar dhe për ta revokuar (shfuqizuar) këtë kontratë.

Në dëshmi të sa më sipër, kjo kontratë hartohet në kater kopje origjinale, nga të cilat nga një kopje u jepet palëve, një kopje mbahet nga Noteri Publik dhe një kopje depozitohet ne Gjykatën e rrethit Tirane, dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan e me zë të lartë dhe mbasi u kuptua nga Palët u nënshkrua rregullisht prej tyre para Noterit.

### PALËT KONTRAKTUESE

SHITËSI

BLERËSI

1- *Rexhe Jure*  
*Luçifi*

2- *Dritan Hoxha*  
*[Signature]*

